

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATI PRANORIMOR / DATE RECEIVED: 17.08.2020			
Numeri Org. Org. Jedin Org. Unit	Stafi klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
03	47	1470	31



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
 Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
 Ministry of Economy and Environment

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

cc. Blerim Kuçi, Ministër

Nga: Mentor Sylmeta, Sekretar i Përgjithshëm

Mentor Sylmeta
 PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE
 të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për Ministrinë e Mjedisit dhe
 Planifikimit Hapësinor, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019

Nr	Komp. e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
Çështja A1 - Mos zbatim i marrëveshjes për programimin e shlyerjes së borgjit							
1	Të hyrat	Ministri i MMPH-së në vitin 2018, kishte lidhë marrëveshje me kompanitë publike rajonale të ujit me	Ministri duhet të siguroj se procedurat për shlyerje të borxheve po zbatohen në	Autoriteti Rregullativ i Pellgjeve Lumore - ka planifikuar dhe do të veproj	Autoriteti Rregullativ i Pellgjeve Lumore dhe Inspektorati i Ujërave.	Periudha e planifikimit për zbatimin e rekomandimeve do të jetë deri në fund të vitit	Gjithashtu, në zyrarja përgjegjëse pagesa/ ARP është kërkuar nga kompania

Faqe 1 nga 1

	<p>qëllim të programimit dhe shlyerjes së borxheve të akumuluarra për shfrytëzimin e ujit gjatë viteve 2007-2017, duke programuar shlyerjen e tyre, në 5 këste, për 5 vite. Shlyerja e borxhit sipas marrëveshjeve fillon nga viti 2018 dhe përfundon në vitin 2022. Neni 5 i marrëveshjeve parasheh se në rast të mos zbatimit të marrëveshjes me MMPH-në për kthimin e borxhit, kompanive publike të ujit, në mënyrë automatike do të ju pushoj vlefshmëria e lejes ujore dhe për pasojë edhe licenca e operimit nga</p>	<p>përpikëri dhe në rastet e mos respektimit, të marrë masa konkrete ndëshkuese ndaj kompanive ujore, siç parashihet me marrëveshjet për shlyerje të borxhit.</p>	<p>shumë shpejt në mënyrë që, të kërkoj nga të gjithë operatorët ekonomik përfshirë edhe kompanitë publike, që brenda viteve 2020 - 2021 të raportojnë për shfrytëzimin e ujit në mënyrë që, t'ju lëshohet Vendimi Financiar, në rast se brenda dy javësh (pas dërgimit të informacionit), nuk përgjigjen atëherë do të përcjellim tek Inspektorati i Ujërave që, të urdhërohen për pagesat e ujit, e në raste se nuk përgjigjen, atëherë do të</p>		<p>2021.</p>	<p>te cilat kanë marrëveshje me ministrit që, të raportojnë të bëjnë pagesat e ujit shfrytëzuar disa prej tyre nuk janë përgjigjur rreth kërkesën e tyre dhe këto raste mbeten për shqyrtuar në mënyrë që të koordinohen veprimet.</p>
--	--	---	---	--	--------------	--

		<p>Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit".</p> <p>Kemi testuar 5 mostra ku vlera e borxhit për shlyerje sipas marrëveshjeve ishte 216,373€ dhe kemi vërejtur se 3 kompani të ujit nuk kishin shlyer obligimin financiar (këstin) për vitin 2019 sipas marrëveshjes. Vlera e kësteve të pa paguara ishte 128,954€, ministria nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë, siç parashihej me marrëveshje. Kjo kishte ndodhur për shkak të monitorimit të dobët të zbatimit të marrëveshjeve me kompanitë e ujit.</p>		<p>jemi të detyruar që ti revokojmë Lejet Ujore.</p>			
Çështja A2 – Mbikëqyrje e dobët e shfrytëzuesve të ujit							
2	Të hyrat	Neni 10 i Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.02/2016 për	Ministri duhet të sigurojë monitorimin e	Për shkak të numrit të vogël të stafit në	Autoriteti Rregullativ i Pellgjeve	Periudha e planifikimit për zbatimin e	-

	<p>Strukturën e Pagesave të Ujit parasheh që vendimin financiar për pagesa e nxjerrë autoriteti përgjegjës, i cili e ka lëshuar lejen ujore për shfrytëzimin e ujit, shkarkimin e ujërave dhe shfrytëzimin e inerteve.</p> <p>Përveç tjerash, leja ujore lëshuar nga MMPH për shfrytëzuesit e ujit parasheh që për sasinë e ujit të shfrytëzuar, pala obligohet që çdo tre muaj të informoj me shkrim MMPH-në.</p> <p>MMPH në vitin 2019 nuk kishte pranuar raporte lidhur me sasinë e ujit të shfrytëzuar nga 37</p>	<p>procesit të raportimit për shfrytëzimin e ujit nga kompanitë, të sigurojë vlerën financiare të sasisë së ujit të shfrytëzuar dhe të bëjë faturimin në bazë të tarifave të përcaktuara sipas kornizës ligjore.</p>	<p>ARPL, ka qenë e pamundur të bëhet mbikëqyrja e të gjithë shfrytëzuesve të cilët kanë qenë të pajisur me Leje Ujore.</p> <p>Është planifikuar që, të bëhen vizita më të shpeshta nga zyrtarët e ARPL dhe Inspektorati i Ujërave tek të gjithë operatorët që janë pajisur me Leje Ujore dhe të njoftohen se, në raste mos raportimit do të ju revokohen lejet ujore. Gjithashtu, është planifikuar që të bëhet rritja e stafit në mënyrë që, të kemi rritje të vizitave në</p>	<p>Lumore dhe Inspektorati i Ujërave.</p>	<p>rekomandimeve do të jetë deri në fund të vitit 2021.</p>	
--	---	--	---	---	---	--

	<p>kompani (4 prej të cilëve janë kompani publike) të cilat kanë leje ujore, dhe në mungesë të raporteve nuk kishte arritur të sigurojë informata lidhur me vlerën financiare të shpenzimit periodik të sasisë së ujit.</p> <p>Rrjedhimisht, MMPH ka dështuar të bëjë faturimin për sasinë e ujit të shfrytëzuar për këto kompani edhe pse ato posedojnë leje ujore dhe e shfrytëzojnë ujin.</p> <p>Kjo kishte ndodhë për shkak se ministria nuk kishte marrë masa për mungesën e raportimit për sasinë e ujit të shfrytëzuar nga këto kompani.</p>		<p>teren.</p> <p>Po ashtu, Autoriteti Rregullativ i Pellgjeve Lumore dhe Inspektorati i Ujëravë do të koordinohen në mënyrë që, të fillojnë vizitat në kontinuitet tek Operatorët ekonomik dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet ligjore.</p>			
--	---	--	--	--	--	--

Çështja B1 - Mungesa e evidencave për vijueshmërinë në punë

3	Pagat dhe mëditjet	<p>Ligji 03/L-149 Për Shërbyesit civil të Republikës së Kosovës, neni 36 parasheh që: 'Orari i punës së nëpunësve civilë nuk do të tejkalojë dyzet (40) orë në javë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj'. Po ashtu rregullorja 05/2010 për orarin e punës neni 7 parasheh që: " Gjatë orarit të punës të gjithë nëpunësit civil janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo nëpunës civil shënohet në librin e vijueshmërisë apo në regjistrin elektronik".</p> <p>Vendimi i Qeverisë nr.06/39 i datës</p>	<p>Ministri duhet të sigurojë se bëhet monitorimi i rregullt i vijueshmërisë në punë për të gjithë punonjësit e ministrisë dhe në rastet e mos respektimit të orarit të punës të merren masa konkrete siç parashihen me kornizën e aplikueshme ligjore.</p>	<p>Janë hartuar draft Marrëveshjet e Mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Komunave përkatëse dhe Ministrisë sonë (MEA) në angazhimin këtyre zyrtarëve të cilët janë integruar sipas marrëveshjes së Brukselit në Ministrinë tonë nëpër komunat përkatëse. Objekt i kësaj Marrëveshje është vendosja e mekanizmit të përshtatshëm për angazhimin e zyrtarëve të integruar që janë</p>	<p>MEA (Divizioni i Personelit), MAPL dhe Komunat përkatëse.</p>	<p>Qershor 2021</p>	-
---	--------------------	---	---	---	--	---------------------	---

		<p>22.07.2015, aprovon konkluzionet e dakorduara për zbatimin e të ashtuquajturës "Mbrojtja Civile". Në MMPH ishin caktuar të punojnë 38 ish pjesëtar të "Mbrojtjes Civile" të cilët ishin pajisur me akt emërime të cilat ua kanë siguruar vendin e punës.</p> <p>Ne kemi vërejtur se për 36 zyrtarët e lartcekur, ministria nuk ka dëshmi për ta konfirmuar prezencën e tyre në vendin e punës, apo raporte për punën e kryer gjatë vitit 2019, përderisa ministria kishte bërë pagesën e rregullt të</p>		<p>pjesë e stafit të MEA-së, në kuadër të procesit të punës në komunën përkatëse, ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> - MAPL- ka përgjegjësinë e koordinatorit në mes të komunës përkatëse dhe ministrisë tonë; • MEA, realizon pagat në baza mujore për zyrtarët e integruar sipas listës së pagave, pranon raporte javore për punën e zyrtarëve të integruar dhe 			
--	--	---	--	---	--	--	--

		<p>pagave të tyre.</p> <p>Vlera financiare për shpenzimet e pagave për vitin 2019 për këta 36 zyrtar ishte 163,198€. Kjo gjendje ishte e njëjtë edhe në vitin e kaluar dhe e njëjta ishte raportuar në raportin tonë të auditimit për vitin 2018. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk janë zbatuar kontrollet menaxheriale për të siguruar se të gjithë të punësuarit janë të pranishëm në vendin e punës gjatë orarit të punës</p>		<p>përgatit plan vjetor të aktiviteteve në bashkëpunim me zyrtarin përkatëse;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komuna përkatëse, angazhon zyrtarët në departamente përkatëse, siguron evidentimin e vijueshmërisë në punë në baza ditore me ç' rast edhe dërgon raportet në MEA, monitoron kryerjen e punëve nga zyrtarët e integruar dhe bën 		
--	--	---	--	--	--	--

Çështja B2 - Angazhimi me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta pa procedura të rekrutimit dhe më gjatë se gjashtë muaj							
				vlerësimin vjetor të tyre dhe i dërgon në MEA.			
4	Mallrat dhe shërbimet	Sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Neni 12, pika 4 - emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" (MShV) të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Kemi testuar 6 mostra të cilat ishin emëruar me marrëveshje për shërbime të veçanta dhe kemi identifikuar	Ministri duhet të siguroj se angazhimet me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta bëhen duke aplikuar procedurat e thjeshtësuara të rekrutimit të parapara me ligj dhe kohëzgjatja e tyre të jetë brenda afatit 6 mujor.	Bazuar në kërkesat e shërbimeve (vetëm ato të domosdoshme) do të respektohet Ligji për Prokurim Publik.	Sekretari i Përgjithshëm.	Bazuar në kërkesa.	-

		se në dy raste të cilët ishin të angazhuar si roje pylli në parkun kombëtar, afati kohor i angazhimit ishte më shumë se gjashtë muaj. Po ashtu për këto dy raste ministria nuk kishte zhvilluar ndonjë procedurë të rekrutimit në vitin 2019.					
Çështja A3 - Tejkalmi i vlerës së kontratës kornizë							
5	Mallrat dhe shërbimet	Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/ L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, neni 22, parasheh se "Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se tridhjetë e gjashtë (36) muaj, ajo nuk	Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin në vazhdimësi ecurinë e realizimit të kontratave, në mënyrë që të parandalohen tejkalmet e furnizimeve. Në rastet kur tejkalmi i kontratës arrin shkallën 30%	Do të ndërmerren të gjitha masat që, në të ardhmen mos të përsëriten këto tejkalime. Gjithashtu, do të ketë shtim të kontrollit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm Divizionit të Prokurimit lidhur me menaxhimin e kontratave, ku do të njoftohen	Sekretari i Përgjithshëm/ Divizioni i Prokurimit/ Menaxherët e kontratave.	Në çdo kontratë.	-

		<p>mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedurat e reja të prokurimit. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e kontratës publike kornizë duhet të përcaktohet që në fillim të procesit të prokurimit. Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative.</p> <p>Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e</p>	<p>kontrata duhet të ndërpritet menjëherë.</p>	<p>të gjithë menaxherët e kontratave lidhur me përgjegjësitë e tyre të Përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik dhe Rregullat dhe Udhëzimin Operativ për Prokurim Publik.</p>			
--	--	--	--	--	--	--	--

		<p>mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër-blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%) pa marrë parasysh datën origjinale të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht".</p> <p>MMPH me datën 12.07.2016, kishte lidhur kontratën publike kornizë "Furnizim me toner</p>					
--	--	---	--	--	--	--	--

		<p>për nevojat e ministrisë. Vlera e kontratës ishte 44,953€. Ne kemi identifikuar se MMPH gjatë periudhës 2016-2019 kishte bërë furnizime në vlerë 64,814€, duke bërë tejkalimin e vlerës së kontratës për 6,375€³ mbi normën e lejuar 30%.</p> <p>Kjo ka ardhur si rezultat i një mbikëqyrje të dobët të ecurisë së realizimit të kontratës nga menaxheri i kontratës.</p>					
Çështja A4 – Mos dërgimi i planit për subvencionim të OJQ-ve në Qeverinë e Kosovës							
6	Subvencionet dhe transferet	Rregullorja Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve - neni 6 'Plani vjetor i	Ministri duhet të siguroj që më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës, të përgatisin planin	Në të ardhmen do të dërgohet plani vjetor i mbështetjes financiare për OJQ-të dhe do ti dërgohet Zyrës përkatëse për	SP/Njësitë shpenzuese.	Janar 2021.	-

	<p>mbështetjes financiare' parasheh se ofruetit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ- të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.</p> <p>MMPH kishte subvencionuar 33 OJQ gjatë vitit 2019. Ministria nuk kishte dërguar planin vjetor të mbështetjes</p>	<p>vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të dhe t'ia dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit.</p>	<p>Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit.</p>			
--	--	--	--	--	--	--

		financiare për OJQ-të në zyrën përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, siç parashihet me rregulloren për subvencionim të OJQ-ve. Kjo kishte ndodhur për shkak se MMPH e kishte neglizhuar këtë proces.					
Çështja B3 – Pagesat përmes vendimeve gjyqësore							
7	Investimet kapitale	Neni 4 pika 2 e Udhëzimit Administrativ nr. 08/2009 për Ekzekutim dhe Pagesën e Vendimeve Përmbarese të Gjykatave, përcakton se "Departamenti i Thesarit verifikon nëse lënda shkresore është e kompletuar dhe urdhëri ose vendimi përmban të	Ministri duhet të sigurojë që pas pranimi të vendimeve nga Gjykata të siguroj kompletimin e dokumentacionit nga akterët e përfshirë në proces me qëllim që lënda të kompletohet dhe të procesohet për pagesë.	Në pjesën e mbetur të këtij viti, planifikojmë të rrisim edhe më shumë nivelin e bashkëpunimit me avokatët që, të kuptojnë përgjegjësinë e kompletimit të dokumenteve sipas procedurave ligjore standarde. Nëse avokatët vazhdojnë me	Departamenti i Shpronësimit.	Rekomandimi është në zbatim e sipër dhe do të vazhdojmë me zbatimin e tij edhe në pjesën e mbetur të këtij viti, varësisht nga buxheti i disponueshëm.	-

	<p>dhëna të plota dhe të sakta për debitorin dhe kreditorin të cilat duhet të paguhen, informatat lidhur me llogarinë e tyre bankare, organizatën buxhetore nga buxheti i secilës duhet të paguhet urdhëri ose vendimi, si dhe shumën e përcaktuar në urdhër ose vendim".</p> <p>Ne kemi identifikuar se shpenzimet e realizuara përmes vendimeve gjyqësore ishin 583,667€. MMPH paguan vazhdimisht shpronësime përmes vendimeve gjyqësore. Kjo, për</p>		<p>mos bashkëpunim dhe pa përgjegjësi e mirëkuptim, ne do të inicojmë procedura disiplinore në Odën e Avokatëve të Kosovës dhe instanca gjyqësore.</p>			
--	--	--	--	--	--	--

	<p>shkak se pronarët që kanë qenë pjesë e procesit të shpronësimit, në rastet kur ata janë të pa kënaqur me vendimin përfundimtar të shpronësimit, kanë të drejtë të ankohen në gjykatë. Në disa raste kur pala fiton kontestin, nuk dërgon dokumentacionin e nevojshëm për pagesë në ministri, si kopjen e llogarisë bankare dhe letërnjoftimit, por e dërgon direkt te përmbaruesi. Kjo shkakton shpenzime shtesë për procedura përmbarimore. Nga pagesat e bëra ne kemi testuar gjithsej</p>					
--	---	--	--	--	--	--

		<p>5 mostra në vlerë 432,398€, ku në kuadër të kësaj vlere kemi vërejtur se ishin paguar shpenzime përmbareme në vlerë 9,371€.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë që kishte ministria për t'i siguruar kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për procedim të pagesës.</p>					
Çështja B4 - Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve brenda kategorisë Investime kapitale							
8	Investimet kapitale	Sipas nenit 18 të Rregullores 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate të përcaktuara me Udhëzimin administrativ për planin kontabël. Plani	Ministri duhet të siguroj se për vitet vijuese shpenzimet e shpronësimit të regjistrohen sipas planit kontabël në mënyrë që ato të klasifikohen saktë.	Ky rekomandim është zbatuar.	Divizioni për Buxhet dhe Financa.	-	-

	<p>kontabël parasheh regjistrimin e secilit shpenzim në kodin adekuat brenda kategorisë ekonomike.</p> <p>Pothuajse të gjitha pagesat për shpronësimet e tokave nuk regjistrohen në kodin adekuat 32100 – Toka, por regjistrohen si ndërtim i auto rrugëve 31210 dhe të tjera. Vlera e keq klasifikimeve brenda kategorisë së investimeve kapitale ishte 3,730,099C. Vlen të theksohet se MMPH pas marrjes së raportit tonë të auditimit, ka filluar që shpenzimet e shpronësimit t'i regjistroj në kodin adekuat.</p>					
--	--	--	--	--	--	--

		Kjo kishte ndodhur për shkak të moszbatimit me konsistencë të planit kontabël nga ana e zyrtarëve financiar.					
Çështja A5 - Mos azhurnim i regjistrit të pasurive							
9	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, neni 13 blerja dhe ndërtimi i pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore përcakton se: të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në	Ministri duhet të siguroj që regjistri i pasurive të azhurnohet me kohë, me qëllim që vlera e pasurive jo financiare të prezantohet drejtë në RVF dhe të gjitha pasuritë që financohen për organizatat tjera pas plotësimit të kushteve të barten tek përfituesit.	Do të ndërmerren të gjitha masat që, në të ardhmen regjistri i pasurive të azhurnohet në kohë reale me qëllim që vlera e pasurisë të jetë e saktë dhe, pas plotësimit të kushteve të barten tek përfituesit.	Divizioni për Buxhet dhe Financa - Zyrtari i Pasurisë.	Në kontinuitet të vazhdueshëm gjatë tërë vitit.	-

	<p>kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyllë llogarinë e investimeve në vijim, ndërsa organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj.</p> <p>Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk është prezantuar saktë në RVF. MMPH projektet e financuara për përfituesit tjerë me rastin e pagesës i kishte regjistruar si</p>					
--	---	--	--	--	--	--

		<p>investime në vijim mirëpo edhe pse kishte përfunduar projekti dhe ishte bërë pranimi teknik ato nuk ishin fshirë nga regjistri i pasurive të ministrisë. Projektet e identifikuar janë:</p> <p>Impianti për riciklimin e mbeturinave në Komunën e Mitrovicës në vlerë 2,321,194€ (pranimi teknik 19.12.2019), Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Breznicë në Komunën e Obiliqit në vlerë 28,199€ (pranimi teknik 20.11.2019), dhe Kanali për ujin dhe parandalimin e rrëshqitjes së tokës në Komunën e Shtërpcës 55,978€ (pranimi teknik 27.11.2019).</p>					
--	--	---	--	--	--	--	--

		Shkaku i mos largimit të këtyre projekteve nga regjistrat e pasurive kapitale sipas ministrisë është se këto projekte janë përfunduar në fund të vitit 2019, prandaj nuk kanë arritur të barten te organizatat përfituese ku edhe e gëzojnë të drejtën e pronësisë.					
Çështja A6 – Inventarizimi i pasurive jo në pajtim me rregulloren							
10	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, neni 6 parasheh që "Zyrtari Kryesor Administrativ ka përgjegjësi të themelojë Komisionin për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare dhe Komisionin për Inventarizimin e	Ministri duhet të siguroj që çdo fund vit të formohen komisionet e parapara me rregullore për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive në mënyrë që të shmangen devijimet në raportimin e vlerës së pasurive në Raport Vjetor	Ne fillim të muajit Tetor 2020 do të formojmë komisionin për Inventarizim.	Sekretari i Përgjithshëm.	23/12/2020.	-

		<p>Pasurisë jo Financiare”.</p> <p>Ministria, nuk kishte themeluar komisionet për vlerësimin dhe inventarizimin e pasurive jo financiare dhe si rezultat i kësaj nuk ishte bërë vlerësimi dhe inventarizimi i pasurive për vitin 2019. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos përfilljes së procedurave të rregullores nga menaxhmenti i ministrisë.</p>	Financiar.				
Çështja A7 - Mungesë e veprimeve ndaj shfrytëzuesve të ujërave pa leje ujore							
11	Llogaritë e arkëtueshme	Ligji nr. 04L-147 Për Ujërat e Kosovës neni 97, parasheh në hollësi veprimet dhe kompetencat që duhet të ndërmarrë Inspektorit i ujërave në rastet kur	Ministri të sigurojë se po bëhet monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të ujërave të Kosovës dhe në rastet e keqpërdorimit	Inspektorati i MEA-së, ka fut në plan të punës për vitin 2020 dhe do të filloj me masa ligjore ndaj kompanive të cilave i'u kanë skaduar	Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor.	31/12/2021.	-

	<p>identifikon kryerje të aktiviteteve pa leje ujore apo në kundërshtim me lejen. Kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e nxjerra në bazë të këtij Ligji, inspektori i ujërave i raporton Ministrisë me shkrim për parregullsitë dhe mungesat dhe me aktvendim do t'i caktojë masat dhe afatet për eliminimin e tyre. Inspektori për ujëra dhe inspektori i autorizuar i ujërave duhet ta informojë policinë kur dyshon se është kryer vepër penale në pasuritë ujore.</p> <p>Nga regjistri i pranuar</p>	<p>nga kompanitë që operojnë në këtë fushë, të marrë masa konkrete për ndalimin e veprimeve të jashtëligjshme sipas dispozitave të parapara me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>dokumentet përkatëse-lejet ujore.</p> <p>Ndërsa, deri ne fund të vitit 2021, planifikohet që kjo problematikë me leje ujore për ambalazhuesit e ujit të marr zgjedhjen përfundimtare.</p>			
--	---	--	--	--	--	--

	<p>prej ministrisë për shfrytëzuesit e ujit kemi vërejtur se, janë mbi 70 detyrues (shfrytëzues të ujit) të cilëve ju ka skaduar leja ujore dhe sipas ministrisë nuk iu ka vazhduar më për shkak të mos shlyerjes së borxheve të akumuluar. Edhe pse, sipas ministrisë këta shfrytëzues vazhdojnë të shfrytëzojnë ujin pa leje ujore dhe pa e kryer obligimin financiar, inspektorati nuk kishte marrë veprime konkrete për ndërprerjen e aktiviteteve të tyre. Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i ankesave të vazhdueshme të shfrytëzuesve të ujit të cilët e kanë kundërshtuar pagesën e taksës së përcaktuar sipas UA nr.06/2006</p>					
--	---	--	--	--	--	--

		Për strukturën e pagesave të ujit, me arsyetimin se tarifat ishin shumë të larta në krahasim me vendet e rajonit.					
Çështja A8 - Mbivlerësim i obligimeve të papaguara							
12	Detyrimet e papaguara	Obligimet e papaguara të raportuara sipas nenit 17 të RVF-së ishin prezantuar në vlerë 265,750,022€, ndërsa do të duhej të prezantoheshin në vlerë 233,514,955€, duke shkaktuar një mbivlerësim prej 32,235,067€. Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarit financiar i cili ka prezantuar dy herë kërkesat e shpronësimit në raportin e obligimeve dhe rrjedhimisht këto shënime janë bartur	Ministri të siguroj se mbahen evidenca adekuate lidhur me obligimet e ministrisë në mënyrë që shënimet në RVF të jenë të sakta.	Do të ndërmerren të gjitha masat që në të ardhmen të implementohet rekomandimi i ZKA.	Divizioni për Buxhet dhe Financa.	31/12/2020.	Me përgatitje e pasqyrave vjetore financiare për vitin 2020 k rekomandimi do të implementohet

		edhe në RVF.					
Çështja A9 - Mos-pagesa e obligimeve financiare të shpronësimit							
13	Pagesat e Shpronësimeve	Neni 39 i Ligjit nr. 03/1-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë parasheh se "Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për të	Ministri i MMPH-së në bashkëpunim me akterët tjerë të ndërlidhur në këtë proces, të siguroj buxhet të mjaftueshëm për t'i kryer obligimet financiare të shpronësimeve të cilat janë duke u	Edhe këtë vit, planifikojmë të kërkojmë nga Qeveria të rritet buxheti për shpronësim me qëllim të pagesave të shpronësimit. Gjatë muajit të kaluar të këtij	MF/MEA.	Rekomandimi është në zbatim e sipër bazuar në mundësitë buxhetore, përndryshe me buxhetin aktual do të përsëritet situata edhe më e rënduar për vitet e	Buxheti i nd për vitin 202 nuk i mbulo kompensimi aplikimeve t vitit 2018, 20 dhe 2020

		<p>siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimi të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore”.</p> <p>Kemi vërejtur se 31,591,176€, ishte vlera e aplikimeve (kërkesave) të pronarëve për kompensim të shpronësimit në vitin 2019, të cilat nuk kanë arritur të procedohen për pagesë. Kjo ka</p>	<p>rritur nga viti në vit.</p>	<p>viti në sistemin e PIP në kërkesën buxhetore kemi kërkuar për vitin 2021 të rritet buxheti në vlerën prej 50 milion euro me qëllim të shlyerjes së borgjeve në një masë të konsiderueshme. Gjithashtu, për pjesën e dytë të vitit 2020 planifikojmë të kërkojmë nga Qeveria të ndaj buxhet shtesë.</p>		<p>ardhshme.</p>
--	--	---	--------------------------------	---	--	------------------

		ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore të ndara për shpronësime.					
Çështja B5 - Vonesa në pagesën e obligimeve							
14	Pagesat e Shpronësimeve	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39, paragrafi 1 parasheh që ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të	Ministri duhet të siguroj se, të gjitha obligimet paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor në mënyrë që të shmangen pagesat direkte nga Thesari.	Për Çështjen B5 nr. 14, vlen Çështja A9 nr.13 sepse arsyeja kryesore është mungesa e buxhetit. Në të gjitha rastet kur DSH ka buxhet, çdo aplikim procedohet për pagesë brenda afatit të përcaktuar ligjor-nëse lënda është e kompletuar.	Departamenti i Shpronësimit.	Qershor 2021.	Si pasojë e mungesës : buxhetit dft vonesa ve n këtë vit, do ketë vështiri në zbatimir këtëj rekomandiu sidomos pë vendime gjyqësore se DSH çdo vendim gjyqësor e k proceduar p pagesë bren afatit por si pasojë e mungesës si buxhetit tan kanë kaluar afatet për lëndët e

		<p>faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ministria, mbi 236,941€, obligime nuk i kishte paguar brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditëve. Këto obligime kanë të bëjë me mallra dhe shërbime dhe investime kapitale.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të mos zbatimit në tërësi të rregullave ligjore për shpenzimin e parasë publike nga zyrtarët përgjegjës për t'i shlyer obligimet brenda afatit të paraparë</p>					pranuara d me datë 1 korrik 2020
--	--	---	--	--	--	--	----------------------------------